



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

GUSHT, 2022

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujoy bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujoye 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin gusht 2022 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit gusht 2022, zënë 46 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 337/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 6.3/100.000 banorë. NJVKSH Berat, Bulqizë, Kukës, mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së saktë klinike, dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin gusht 2022 në nivel kombëtar, përkatësisht 7 raste të konfirmuara me Salmonelozë jo-tifoide dhe 4 raste të konfirmuara me Shigelozë.

**Tabela 1: Frekuencat dhe incidenat e sëmundjeve diarreike për muajin gusht 2022
(Incidenca raste/100.000 banorë)**


	Raste gusht 2022	Incidenca gusht 2022 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	7	0.24
Shigelozë (Disenteri bacilare)	4	0.14
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	180	6.3
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	9454	330.3
Sëmundje diarreike në total	9645	337

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1. Varicela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit gusht 2022 janë raportuar në total 57 raste Varicele (Incidenca 2.0/100.000 banorë) nga të cilat 48 raste janë të dyshuara dhe 9 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen Varicelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Fier (37 raste) dhe NJVKSH Tiranë (4 raste). Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 27 raste. (Graf 1)

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, gusht 2022




3. Hepatitet virale


Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit gusht 2022 janë raportuar në total 33 raste me hepatite virale akute (Incidenca 1.2/100.000 banorë) nga të cilat, 26 raste (Incidenca 0.9/100.000 banorë) janë Hepatit viral B (HBV) dhe 7 raste (Incidenca 0.2/100.000 banorë) janë Hepatite virale C (HCV). Rastet me HBV i përkasin te gjitha bashkisë Tiranë.

Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 35-39 vjeç dhe 40-49 vjeç me 5 raste secila. (Graf 2, 3)

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve me HBV sipas grup-moshës, gusht 2022



Grafiku 3. Përqindja e rasteve me HBV sipas grup-moshës, gusht 2022



Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 35-39 vjeç (19%) dhe 45-49 vjeç (19%).

Rastet me HCV i përkasin bashkisë Tiranë (7 raste). Edhe këto raste janë të shpërndara në grup-moshat aktive, nuk ka raste në grup-mosha pediatrike.

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS

4.1 HIV/AIDS

Gjatë muajit gusht 2022 janë kryer 15 ekzaminime (7 meshkuj dhe 8 femra) për HIV prej të cilave 7 raste (5 meshkuj dhe 2 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv, ndërsa 1 rast pozitiv ishte konfirmuar më parë. Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv është: Tiranë 3 raste, Shkodër 1 rast, Korça 1 rast, Durrës 1 rast dhe Elbasan 1 rast. Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 20-24 vjeç, 1 rast grup-moshës 25-34 vjeç, 2 raste i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 55-59 vjeç dhe 1 rast i përket grup-moshës 65 + .

Rastet e dyshuara kanë ardhur si më poshtë:

2 raste janë referuar nga Shërbimi Infektiv pranë QSUT, 1 rast është referuar nga VCT Durrës, 1 rast referuar nga laborator i privat INTERMEDICA, 1 rast nga klinika ambulatorë, 1 rast nga VCT Korçë dhe 1 rast është vullnetar i ardhur në ISHP.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit gusht 2022 janë raportuar 18 raste me TB pulmonar. 18 rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 9 raste në Tiranë, 4 në Laç, 2 në Dibër, 1 në Shkodër, 1 rast në Korçë. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh, por në shtrirje rastet janë pothuasje në gjithë vendin. Bashkëpunimi me epidemiologun në rreth, me mjekun e familjes dhe pneumologun duhet të përforcohet më shumë për kontrollin e TB-së në rrethet përkatëse.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2. Shpërndarja e zoonozave në muajin gusht 2022, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks Bruceloze, Leptospirozë, Rikecie).

	Gusht (Raste 2022)	Incidenca (raste/100,000) 2022
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	2	0.1
Leptospirozë	1	0.03
Rikecie	0	0

Incidenca e Brucelozës në nivel vendi është 0.1/100.000 banorë. Për muajin gusht janë raportuar 2 raste Bruceloze, të konfirmuara. Rastet përkatësisht janë 1 rast në Korçë dhe një rast në Kukës.

Për muajin gusht është raportuar 1 rast i dyshuar me Leptospirë nga NJVKSH Fier.


7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19

COVID-19 gusht 2022


Gjatë muajit gusht janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 12967 raste të konfirmuara me COVID-19, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin gusht është 453 raste /100000 banorë. Gjatë muajit gusht vërehet që numri i rasteve të konfirmuara me COVID-19 është më i ulët se në muajin korrik.

Grafiku 1. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 899.4 raste për 100000 banorë e ndjekur nga grup-mosha 75+ vjeç me incidencë 717.5 raste për 100000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive



Bashkitë me incidencë më të lartë janë bashkia Himarë, Sarandë, Gjirokastrë, Tepelenë etj.

7.2 Grip

Gjatë muajit gusht në Survejancën e Integruar ILI/SRRA janë raportuar 524 raste nga të cilat 122 (23.3%) janë raste ILI, ndërsa 402 (76.7%) raste SARI. Rastet janë testuar për viruset e gripit dhe kanë rezultuar të gjitha negative.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI